



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e premte, në datën 29 prill 2022, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Gentian Biqiku për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor “M&G”. (**Vendimi nr. 41, datë 29.04.2022**)
2. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Eduart Azizolli për rinovimin e autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor Iliria”. (**Vendimi nr. 42, datë 29.04.2022**)
3. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “SABATEL” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor Digital”. (**Vendimi nr. 43 datë 29.04.2022**)
4. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Manushaqe Dervishi, për rinovimin e autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Ani”. (**Vendimi nr. 44, datë 29.04.2022**)
5. Pranimin e kërkesës së subjektit, shoqërisë “RrTL-OTT” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, online mbështetur në rrjet IP (OTT) “RrTL-OTT”, për ndryshimin e emrit tregtar nga “RrTL-OTT” sh.p.k., në “Oda TV” sh.p.k. dhe ndryshimin e emrit të subjektit nga “RrTL-OTT” në “ODA TV”. (**Vendimi nr. 45, datë 29.04.2022**)

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 29 prill 2022